



|   |                                 |                             |                                 |
|---|---------------------------------|-----------------------------|---------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Punë/ona/Prodato<br>Received/Delivery | 02.11.2023                      | 3 viti<br>god<br>year       |                                 |
| Organ / Njësia<br>Org./Unit                                 | Nr. Prot<br>Pr. Prot<br>Prot No | Shtesa<br>Punëg<br>Appendix | Sasia<br>Kolicitina<br>Quantity |
| SKAMSHEK  | 6837/2023                       |                             | 1/4                             |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1148/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1148/2023 të datës 07.09.2023 të ankueses [redacted] me adresë banimi: Rruga [redacted] Komuna e Gjakovës, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPD, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar, ankesa A.nr.1148/2023 e datës 07.09.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 05.05.2023 ka shpallur konkursin për grupin "Specialistë të Arsimit", pozita "Inspektor i Arsimit" në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja [redacted] e pakënaqur me vlerësimin e jetëshkrimit me datë 26.08.2023 ka parashtruar ankesë te Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Ankuesja për shkak të heshtjes administrative nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, e njëjta ka parashtruar ankesë përmes e-maili me datë 06.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me datë 07.09.2023 me numër protokoll: 1560/2022 me pretendimet ankimore së konkursi është zhvilluar me shkelje procedurale dhe materiale, më kërkesën që konkursi i shpallur i datës 05.05.2023 të anulohet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 13.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa Këshilli me datë 22.09.2023 ka pranuar përgjigjen me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesë së Kryetarit të Kolegjit, me datë 20.10.2023 kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6629/2023 përmes të cilit ankesës së ankueses me shifër A.nr.1148/2023 të datës 07.09.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli:6004/2023 e datës 07.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.09.2023 përcjellë nga ankuesi në Këshill; Ankesën e ankueses të datës 26.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.09.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 22.09.2023; Kopjen e konkursit të datës 05.05.2023; Njoftimin e datës 19.07.2023 për listën e ngushtë; Vendimin e datës 12.07.2023 me shufër Nr.05/151; Vendimin për vlerësimin përfundimtar i datës 11.09.2023; Formularin e renditjes përfundimtare; Aplikacionin e ankueses të datës 31.05.2023 me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.K të datës 28.05.2023 me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.S me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.U me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.Zh dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.S me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës B.B me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës D.L me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës E.L-P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatës A.P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit G.S me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit J.B me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit K.R me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit M.F me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit M.G me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit M.D me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit M.Rr me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit N.P me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit P.R me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit R.M me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit S.A me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit S.S me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit Sh.B me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit V.K-Z me dokumentet e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, gjegjësisht sipas Njoftimit të datës 19.07.2023 ka gjetur se ankuesja ka qenë pjesë e procedurës së rekrutimit për pozitën "Inspektor i Arsimit" të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme sipas konkursit të datës 05.05.2023 me shifër reference RN0005227, ndërsa e njëjta pas fazës së mbajtjes së testit me shkrim me datë 26.08.2023 përmes e-mailit i ishte drejtuar me ankesë zyrtarëve të Departamentit



për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe anëtarëve të Komisionit të Pranimit me pretendimet ankimore për shkelje gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë së shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me procedurën e rekrutimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *"Kandidati në procedurën e pranimin në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet",* andaj në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurrimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje"* Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar më Këshill me datë 07.09.2023 është e palejueshme pasi që e njëjti nuk ka parashtruar ankesë kundër aktit përfundimtar, respektivisht e njëjta nuk ka parashtruar ankesë kundër heshtjes administrative lidhur me ankesën që ka ta bëjë me goditjen e aktit përfundimtar, ngase sipas shkresave të lëndës, akt përfundimtar del të jetë njoftimi i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në kuptim të paragrafin 1 dhe 5 të nenit 25 të së njëjtës rregullore ku parashihet se: *"1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj; 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual",* kurse ankesa e ankueses e 26.08.2023 është e mëhershme dhe s'ka të bëjë me goditjen e aktit të përfundimit të procedurës e që e bënë të palejueshme ankesën e sa të datës 07.09.2023 të parashtruar pranë Këshillit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit njëzëri konstaton se meqenëse ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se e njëjta pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër njoftimit të datës 11.09.2023, ankesa e ankueses është e palejueshme ngase faze e testit me shkrim apo jetëshkrimin nuk llogariten akt përfundimtar i përfundimit të procedurës së rekrutimit në kuptim të nenit 31 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankueses në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji"* ankesa e ankueses vlerësohet të jetë e palejuar ngase ligji material e ka përjashtuar parashtrimin e ankesës në Këshill, nëse paraprakisht nuk goditet akti përfundimtar në procedurë të rekrutimit, e që në rrethanat e rastit

konkret është konstatuar fakti se ankuesja nuk e ka kundërshtuar me ankesë Njoftimin e datës 11.09.2023 të Komisionit të Pranimit sikurse përcaktohet me neni 31 paragrafi 4 nën paragrafi të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr.1148/2023

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Eshref SHABANI**

*Kryetari i Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Arkivit të KPMSHCK-së

